

VENDIM
Nr. 91/2025

**PËR MOSMIRATIMIN E KËRKESËS PËR ZHVILLIMIN E MOCIONIT ME DEBAT
MBI GJETJET E RAPORTIT TË KLSH-së “MBI DISPONIBILITETIN E BARNAVE PËR
TRAJTIMIN E SËMUNDJEVE TUMORALE”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 55 dhe 98, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kërkesës për zhvillimin e mocionit me debat mbi gjetjet e raportit të KLSH-së “Mbi disponibilitetin e barnave për trajtimin e sëmundjeve tumorale”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025.